



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2022:159959

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05719518

C.nr.709/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN-Departamenti i Përgjithshëm, në përbërje prej gjyqtarit Zenel Tasholli, gjyqtar individual, në çështjen juridike kontestimore të paditësisit S. K..nga L...të cilin me autorizim e përfaqëson Valon Sadiku av nga Lipjani, kundër të paditurës Komuna e Lipanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Lipjan, me objekt kontesti kompensim i ushqimit gjatë punës dhe shpenzime të udhëtimit, jashtë seance gjyqësore, me dt.10.05.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

I.APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit S..K...nga L...si e bazuar.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Lipjanit– Drejtoria e Arsimit, që paditësit në emër të kompensimit të shujtave për ditët në punë, t’ia paguaj për 155 ditë të punës për periudhën nga data 01.01.2021 deri me dt.21.11.2022 të përlogaritur sipas shumës nga 2 euro në ditë shumën e përgjithshme prej **310.00-€**, si dhe në emër të pagesës së shpenzimeve të udhëtimit për periudhën e njëjtë kohore shumën prej **70.00 €** me kamatë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë dt.08.08.2022 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 228.00 euro .

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Lipjanit – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shujtave, sipas padisë paditësi është mësimdhënës në SHMU”D.. D...” në fsh.D..e M... dhe i njëjti i plotëson kushtet e përfitimit të shujtës ditore dhe shpenzimeve të udhëtimit, sipas kushteve të parapara më Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, për çka pretendon se i takon kompensimi i ushqimit në punë-shujtave ditore dhe shpenzimeve të udhëtimit.

I autorizuari i paditësit përmes parashtrës së datës 20.11.2023 ka bërë precizimin e padisë duke kërkuar nga gjykata që të obligoj të paditurën që t’ia kompensoj paditësit për 155 ditë në punë shumë prej 310 euro për periudhën nga dt. 01.01.2021 deri me dt.21.11.2022, si dhe për të njëjten periudhë kohore shpenzimet e udhëtimit në shumë prej 70 € me kamatë prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore që do të shkaktohen .

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi. E paditura përmes përgjigjes së saj në padi të parashtruar me datë 29.11.2023, e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkespadiisë dhe se sipas nenit 90 pika 5 te Ligjit 03/L212 të Punës në të cilën thirret paditësi, ku thuhet se marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshje të tilla kolektive e që në rastin konkret e paditura Komuna e Lipjanit si punëdhënëse e paditësit nuk është nënshkruese e kësaj marrëveshje-kontratës kolektive në të cilën është thirrur pala paditëse. Poashtu nëse merret parasysh Kontrata Kolektive në nenin 46 par.2 shprehimisht thotë se pagesa e tillë si për kompensimin e ushqimit bëhet brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, e që konsideron se nuk janë plotësuar këto kushte, sepse të paditurës nuk i janë ndarë mjete financiare nga institucionet nënshkruese të Kontratës Kolektive. I ka propozuar gjykatës që konform dispozitave ligjore të LK-së nenit 399 par.1 dhe 2 padinë e paditësit ta refuzon si të pabazuar-e pathemeltë.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkespadiisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”*, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë (më tej KKAK) në Kosovë (KKAK) të miratuar dhe të nënshkruar nga Ministria e

Arsimi, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Republikës së Kosovës, me datën 22.01.2021.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto prova dhe atë: kontratën e punës për paditësen nr.04-112-813/82 te dt.01.09.2015, çertifikatën e vendbanimit për paditësin nr.ser. Btë lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Lipjan me të cilin vërtetohet se paditesi jeton në Lipjan, vërtetimin nr.366/2023 dt.17.11.2023 të lëshuar nga SHFMU”V...F...” ne fsh.L...për ditët e pranisë në punë me gjithsej 105 ditë pune efektive, vërtetimin nr.2317/1 dt.20.11.2023 të lëshuar nga SHFMU”D.. D...” në fsh.D..e M... për ditët e pranisë në punë me gjithsej 50 ditë pune efektive dhe nga vërtetimi i dt.01.09.2021 i lëshuar nga Kompania N.SH”T..T...” me të cilin vërtetohet se bileta në relacionin L...-P.. dhe ansjelltas është në shumë prej 1.00€.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëri me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe si të tillë e aprovoj në tërësi.

Në bazë të provave të sipërpërmendura dhe përgjigjes së dhënë në padi nga e paditura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU” V.. F...” ne fsh.L...., mirëpo kontestuese është kompensimin i mjeteve në emër të shujtave ditore dhe shpenzimeve të udhëtimit për periudhën përkatësisht ditët si në dispozitiv këtij aktgjykimi, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës të datës 22.01.2021 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK-ut, ku me dispoziten e nenit 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e cila ka hyrë në fuqi me dt. 22.01.2021, parashihet se dispozitat e kesaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha insitucionet publike dhe private të Arsimit parauniversitar (para shkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, Shkolla Speciale e Qendra të Kompetencës) dhe Institucione të Arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtar të SBASHK-ut, dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit ne sektorin e arsimit (komunal - DKA, KD te Universiteteve e institucioneve te arsimit te larte, MASHT-in etj) ne sektorin publik dhe institucionet edukativo – arsimore private ne mbarë territorin e Republikës së Kosovës, përkatësisht sipas neni 35 par.7 si dhe par.8 pika 8.1 në të cilën përcaktohet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës,*

ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”, ndërsa me nenin nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë te dt.22.01.2021, parashihet se punëtorët anëtar të SBASHK-ut punonjesit arsimor kompensohen për shpenzimet e udhëtimit prej 70% te çmimit të biletës, andaj kjo gjykatë vlerëson se paditësit i takon e drejta e kompensimit për shujtë ditore dhe shpenzime të udhëtimit, përkatësisht për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive*”, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar dhe nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shujtës ditore u vendos që të njëjtën t’u aprovojë për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Poashtu poqëse e paditura e konteston kërkesëpadinë, përgjigja në padi duhet t’i përmbajë edhe faktet mbi të cilat i padituri i mbështetë thëniet e tij dhe provat me të cilat provohen faktet e tilla”, në çështjen konkrete juridike vlerëson se paditura nuk i ka bashkangjitur asnjë provë konkrete parashtrësës së përgjigjes në padi, me të cilat do ti vërtetonte pretendimet e saj.

Andaj , meqenëse në mes palëve ndërgjyqëse nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante, fakte të cilat u vërtetuan edhe nga gjykata me shqyrtimin e provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartpërmendura vendosi aprovimin e tërësishëm të kërkesëpadisë së paditësit.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të autorizuarit të të paditurës lidhur me ate se komuna nuk është nënshkruese e kontratës kolektive se nuk kanë parapara mjete financiare për shlyerjen e këtyre detyrimeve, por gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se “Dispozitat e e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në

sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës” prandaj është edhe irelevante për këtë proces gjyqësor se si e paditura i siguron mjetet për kompensimin e këtyre kategorive.

Gjykata për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, duke filluar nga dita e paraqitjes së kërkesëpadisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës, iu referua nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas të cilave paditëses ju pranohen shpenzimet procedurale dhe atë ashtu që e detyroi të paditurën që paditëses t’ia kompensojë në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumën prej 104 euro në emër të parashtrimit të padisë, për parashtrësë për precizimin e kërkesëpadisë shumën prej 104-€, si dhe shumën prej 20.00 euro në emër të taksës gjyqësore, në total shuma prej 228-€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan

Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil

C.nr.709/2022 me datën 10.05.2024

Gj y q t a r i

Zenel Tasholli

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.